

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"OSC GROUP" Sh.P.K

Sot më datë 08.01.2018, mbështetur në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, në cilësinë e ortakut themelues:

- **Z.Malush Çelaj, shtetas shqiptar, me datëlindje 13.03.1947 ,lindur ne Gurez,Kruje dhe banuese në Tirane, person madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. 030152139.**

Deklaron se ka vendosor të nënshkruajë këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë refereruar si Shoqëria), me termat e mëposhtëm:

Neni 1
Emërtimi

Shoqëria emërtohet "**OSC GROUP**" sh.p.k. Emërtimi i shoqërisë të shkruhet me shkronja të mëdha .

Neni 2
Selia

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në adresen: **Njesia Bashkiake Nr.10 Rr."Reshit Çollaku",Pallatet Shalvare,Kati pare. Tirane ,Shqipëri.**

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të BIZNESIT. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Ne fushen e ndertimit. Ndertime dhe rikonstruksione te objekteve nje dhe shumekateshe civile,kulturore,turistike,ushtarake,industriale,monument kulture dhe sportive.
- Ndertim, rikonstruksion ruge, ujesjelles e kanalizime.Sherbime portuale,hekurudhore riparim dhe mirembajtje te mjeteve portuale e detare,grumbullim,largim dhe perpunim te mbetjeve urbane ne zbatim,projektim dhe kolaudim.
- Punime ne siperfaqet e gjelbra urbane,ndertim dhe rikonstruksion e tyre.
- Punime ne varreza publike,ndertim,mirembajtje,rikonstruksion, siper marrje e tyre dhe sherbim funeral.
- Mirembajtje dekori, sinjalistik rrugore pastrimi i zonave urbane ,ndriçim ,sinjalizim ,pastrim i ujrave te zeza,siper marrje,supervizion dhe kolaudim i tyre.



- Punime duro-alumini. Tregetim me pakice i karburanteve, vajrave lubrifikante, autogas dhe furnizim gazi familjare.
- Sherbime bar-restorant, hotelerie, agjensi turistike, agjensi spedicioni, service automjetesh, autoshkolla, lavazh etj.
- Importimi, eksportimi dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i mallrave të ndryshem, industrial dhe bujqesor, si mallra dhe produkte ushqimore, konfeksione, materiale ndertimi, produkte farmaceutike, bime medicinale, makineri e paisje etj.
- Transport kombëtar e ndërkombëtar te mallrave dhe udhetareve per vete e te trete.
- Prodhimi dhe perpunimi i produkteve me karakter industrial e bujqesor, importime dhe eksportimi i tyre.
- Shoqëria mundet të realizoj çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brënda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër do të zhvillohen në te gjith teritorin e Shqipërise.

Neni 5 Kapitali regjistruar

Kapitali themeltar i regjistruar i shoqërisë është 10.000 lekë (dhjetëmijë), i krijuar nga kontributi në para, i ndare në 1 (një) kuotë kapitali në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Kuotat e kapitalit janë të nënshkruara dhe të paguara.

Neni 6 Kuotat e kapitalit të regjistruar

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si vijon:


- Ortaku themelues, **z. Malush Çelaj**, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Derdhja e kontributit për kapitalin themeltar është bërë në masën dhe mënyrën e mëposhtëme:

- **Z. Malush Çelaj** ka kontribuar në para, në shumën 10.000 lekë (dhjetëmijë) lekë.

Neni 7 Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit

Zotërimi i kuotave, mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjesëtimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe nga statuti i shoqërisë.



Neni 8
Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator persona fizike, qofshin këta edhe jo ortak të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori/ët qendrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiarë, me mundësinë për tu rizgjedhur. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti i jep Asamblesë duke përfshirë delegimin e kompetencave edhe personave të tjerë me prokurë të posaçme.

- **Administratori i parë i shoqërisë është z. Malush Çelaj , shtetas shqiptar, me datëlindje 13.03.1947 ,lindur ne Gurez,Kruje dhe banuese në Tirane, person madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. 030152139.**

Mandati i administratorit fillon më datë 08.01.2018 dhe mbaron me datë 08.01.2023 me të drejtë për tu rizgjedhur.

Ai do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për rregjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare e Biznesit (QKB). Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 9
Të tjera

Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 10
Kundërshtimet

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarreveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe shoqërisë do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni 11

Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barazvlerëshme në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË "OSC GROUP" SH.P.K

Malush ÇELAJ

